



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 101/2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese-BIRN me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Kryesuesit dhe Komisionarëve të Qendrës së Votimit për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 26.01.2011, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese-BIRN.

BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP me 24.01.2011. Parashtruesi i ankesës pretendon se më datë 23.01.2011, në QV 1105B, në Shkollën Fillore “Skënderbeu” në Baganicë të Mitrovicës, në VV 05R, pas mbylljes së vendvotimit në orën 19:05 ka filluar numërimi i votave normalisht dhe gjatë këtij procesi të numërimit komisionarët e këtij vendvotimi: Nezir Bekteshi, Ferat Mehmeti dhe Nysret Jonuzi me lejen e kryesuesit të VV, Naim Myftari, kanë dal jashtë disa herë. Sipas pretendimeve të ankuesit komisioneri Nezir Bekteshi nga radhët e PDK-së ka qëndruar jashtë gjatë gjithë kohës pasi janë numëruar votat e subjektit politik PDK. Sipas parashtruesit të ankesës komisionarët e subjekti politik PDK kanë shkaktuar parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në VV në ditën e zgjedhjeve.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe (c) parashohin si vijon:

b) një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar.

(c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku

mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoj të gjitha shkresat e lendes gjeti se:
-ankesa është e pabazuar

PZAP vlereson se ankesa e BIRN-it është e pabazuar për shkakun se ka mungesë të provave për t'u bindur se komisionarët e PDK-së kanë shkaktuar parregullsi dhe se nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar përveç disa emrave: Gresa Musliu, Florent Spahija, Korab Prekazi, Merita Kurshumliu, Agim Begu dhe Naim Myftari si dëshmitar. Prandaj PZAP-i konsideron që BIRN nuk ka vepruar në pajtim me nenin 3.6 pika b dhe c të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it. Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 101/2011 më datën 26.01.2011.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha
Prishtinë / Pristina

